URDHËR
Nr. 552, datë 31.8.2021

PËR MOSRIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQATËS "GRAMM-A" SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË FUSHËN E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE DHE TË VIDEOGRAMEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, 'Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to'", të ndryshuar, kërkesës nr. 3714 prot., datë 16.7.2021, të organizatës për administrimin kolektiv dhe mbrojtjen e të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe të videogrameve "GRAMM-A", "Për ripërtëritjen e licencës si Agjenci e Administrimit Kolektiv", si dhe legjislacionit në fuqi për "Për organizatat jofitimprurëse",

URDHËROJ:

1. Mosripërtëritjen e licencës për organizatën "GRAMM-A" për administrimi kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe të videogramit.
2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti